



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 183, datë 03.06.2021

**PËR SHPALLJEN E VENDEVE VAKANTE PËR DREJTUES TË PROKURORIVE
TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM NËPËRMJET PROCEDURËS SË
NGRITJES NË DETYRË**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 52 pika 5, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, në Rregulloren “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm” miratuar me Vendimin nr.200, datë 23.09.2020 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe në relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Të shpallë fillimin e procedurave për plotësimin e 5 (pesë) vendeve vakante për Drejtues prokurorie, përmes procedurës së ngritjes në detyrë, në Prokuroritë e mëposhtme

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së parë Dibër;
2. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së parë Gjirokastrë;
3. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së parë Kavajë;
4. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së parë Berat;
5. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së parë Përmet;

2. Subjektet të cilët kanë të drejtë të kandidojnë, kriteret që duhet të plotësojnë, afati i dorëzimit të shprehjes së interesit, dokumentacioni që duhet të dorëzojnë dhe adresa ku do të dorëzohet shprehja e interesit, do të njoftohet në faqen zyrtare të Këshillit.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.



KRYETARI
GENT IBRAHIMI